



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "HM Home" të datës 15.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "HM Home" të datës 15.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "HM Home" (tutje "parashtruesi") me datë 15.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Operatori ekonomik HM HOME SH.P.K. parashton këtë ankesë lidhur me moszbatimin e vendimit të OSHP-së nr. 2025/0788, përmes të cilit ishte urdhëruar Autoriteti Kontraktues që brenda afatit prej 10 ditësh të korrigjonte dosjen e tenderit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Në kundërshtim me këtë vendim, Komuna e Prishtinës ka publikuar më 10.10.2025 dosjen e re me të njëjtat kritere diskriminuese dhe joproporcionale, duke treguar qëllim të qartë për të anashkaluar vendimin e OSHP-së dhe për të kufizuar konkurrencën e ndershme".

Lidhur me pretendimet duhet cekur se Komuna e Prishtinës e ka pranuar vendimin e OSHP me shenjën 2025/0788 të datës 06.10.2025. Mirëpo në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi thuhet si vijon "2. Vërtetohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi" me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Lejohet AK të vazhdoj me proeduren e prokurimit". Prandaj pretendimi ankimor i parashtruesit nuk qëndron për faktin që OSHP nuk ka kërkuar nga AK që të ndryshoj DT por e ka vërtetuar dosjen e tenderin në formën siç është, për më tepër e ka autorizuar AK po ashtu që të vazhdoj tutje me procedurën e prokurimit. Pra DT është përputhje të plotë me vendimin e OSHP 2025/0788 të dt. 06.10.2025.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.10.2025

Visar SHKRUHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.